

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o. Findel, Luksemburg, me seli të regjistruar në 1110, Findel, Luksemburg, përmes Shoqërisë së Avokatëve Shosholçeva Gerovski dhe partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 19.06.2025, solli

### **AKTVENDIM**

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o. Findel, Luksemburg, me seli të regjistruar në 1110, Findel, Luksemburg do të fitojë kontroll të vetëm mbi AUGUSTIN QUENBERGER GROUP d.o.o. Strasvalhen, Austri, me seli të regjistruar në Zona Industriale Veriore 5, 5204 Strasvalhen, Austri, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë tarifë administrative për njoftim për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin në vijim: Ligji), më 27.05.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o. Findel, Luksemburg, me seli të regjistruar në 1110, Findel, Luksemburg, me të cilin GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o. do të fitojë kontroll të vetëm mbi AUGUSTIN QUENBERGER GROUP d.o.o. Strasvalhen, Austri, me seli të regjistruar në Zona Industriale Veriore 5, 5204 Strasvalhen, Austri.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit ditën e pranimit të tij dhe, mbi bazën e të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, anekset e tij dhe të dhënave të dorëzuara shtesë më 11.06.2025, konstatoi sa vijon:

**Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

- **GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o.** veprimtari kryesore - kryerja dhe ndërmjetësimi i transportit të mallrave, formalitete doganore dhe shërbime magazinimi të çdo lloji, shërbime ndërkombëtare globale të ekspeditës në fushat e transportit tokësor, ajror dhe detar si dhe realizimi i projekteve. Gjithashtu, blerja dhe administrimi i pjesëmarrjeve në ndërmarrje të çdo lloji, realizimi i shërbimeve logjistike, shërbime të lidhura me prodhimin dhe aktivitete ndihmëse të lidhura me to. Më tej, shoqëria mund të ndërmarrë kryerjen dhe ndërmjetësimin e çdo shërbimi ose pune të lidhur me qëllimin kryesor të shoqërisë ose që mund ta përmirësojë atë.

GEIS CARGO INTERNATIONAL LUXEMBURG d.o.o. bën pjesë në grupin dhe është tërësisht në pronësi dhe kontroll nga ai. Grupi Geis është biznes familjar me 100% pronësi, i cili ofron zgjidhje të standardizuara dhe të personalizuar transporti si dhe një gamë të plotë të shërbimeve logjistike. Ka tre segmente afariste në fushën e logjistikës: Shërbime rrugore, shërbime të kontratave logjistike dhe shërbime ajrore + detare. Shërbimet rrugore janë të fokusuar në mallra të përgjithshme të grumbulluara, ngarkesa të pjesshme (më pak se ngarkesa të plota kamioni; "LTL") dhe ngarkesa të plota kamioni ("FTL"). Gjithashtu, Grupi Geis ofron zgjidhje të transportit për shpërndarje dhe logjistikë furnizimi për industri të ndryshme.

Logjistika e kontratave është e personalizuar: Grupi Geis krijon zgjidhje inovative dhe individuale, nga logjistika individuale e prodhimit deri te qendrat e tërë të shpërndarjes. Shërbimet ajrore + detare janë zgjidhje për transport ajror dhe detar.

Grupi Geis ofron transport ndërkombëtar në mbarë botën me një rrjet global dhe konsulencë lokale.

- **AUGUSTIN QUENBERGER GROUP d.o.o.** – pjesëmarrje në shoqëri, në veçanti fitimi, zotërimi, administrimi dhe disponimi me pjesë në shoqëri nga sektori i speditonit, transportit dhe logjistikës, krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit në logjistikë dhe ofrimi i shërbimeve për shoqëritë në të cilat ka pjesë. **AUGUSTIN QUENBERGER GROUP d.o.o.** dhe degët e saj (AQG dhe degët së bashku formojnë AKG Group („AQG GROUP”))

AKG Grupi është një ofrues ndërkombëtar logjistike me ofertë të plotë, ofron zgjidhje gjithëpërfshirëse nga fillimi në fund në katër fusha kryesore produktesh:

- Logjistikë e kontratave: zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe shumë të personalizuar të zinxhirit të furnizimit që ofrojnë shkallë të lartë fleksibiliteti për klientin;
- Rrjete industriale: paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh rrjeti të personalizuar të ofruara në industri të ndryshme, duke përfshirë tregtinë me pakicë, modën, mallrat e konsumit të shpejtë (FMCG), goma dhe bëje vetë;
- Q Direct: zgjidhje transporti për ngarkesa të plota (FTL) dhe më pak se ngarkesa të plota kamioni (LTL) me përqendrim në Evropën Qendrore dhe Lindore;  
Transporti Ajror + Detar: Shërbime të transportit ajror + detar, të orientuara plotësisht drejt zgjidhjeve, nga fillimi në fund, për të gjitha madhësitë e dërgesave dhe kërkesat e shpejtësisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, AKG Grupi është i pranishëm përmes: **-Shoqërisë për transport ndërkombëtar dhe speditonit QUENBERGER LOGISTIK MAQEDONIA SHPKNJ, Shtip**, me seli në rrugën Bregalnička nr.61, Shtip – aktivitetet për ndërmjetësim në transportin e mallrave.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**